



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Ministria e Punëve të Brendshme shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Arsimit
Institucioni	Ministria e Punëve të Brendshme
Nr. i Referencës	RN00011549
Kodi	RPC0005167
Data e njoftimit	27.04.2023
Afati për aplikim	18.05.2023 - 29.05.2023



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve gjatë kryerjes së detyrës;
- Planifikon aktivitetet në kuadër të pozitës përkatëse të cilat korrespondojnë me planin e njësisë/institucionit përgjegjës për inspektim;
- Siguron zbatimin efektiv të planeve e aktiviteteve inspektuese;
- Është përgjegjës për të siguruar zbatim efektiv të rregullave e procedurave inspektuese duke përdorur njohuri të thella profesionale;
- Është përgjegjës për të ndërmarrë masa ekzekutuese apo inicuar raste të shqyrtimit dhe verifikimit të ligjshmërisë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës;
- Është përgjegjës për të ofruar këshillime, rekomandime e udhëzime profesionale të nivelit të lartë e në përputhje me kërkesat ligjore si dhe standardet teknike e profesionale për të gjitha palët që janë subjekte të inspektimit;
- Është përgjegjës për miratimin/konstatimin e korigjimit të shkeljeve të legjislacionit në fuqi dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin nga këto shkelje;
- Është përgjegjës për marrjen e masave administrative dhe shqiptimit të gjobave që kanë për qëllim shmangien e rreziqeve që mund t'i shkaktohen të drejtave dhe interesave të ligjshme të qytetarëve nga marrëdhënia e punës dhe në shëndetin publik, të përcaktuara nga ky ligj apo me ligje të veçanta.
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve.
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës me theks të veçantë, përvojë e punës në mësimdhënie.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Realizim i detyrave me njohuri të thella profesionale të fushës përkatëse;
- Puna kryhet brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave;
- Detyrat/Projektet realizohen në përputhje me politikat e institucionit, me standardet administrative dhe procedurat teknike, si dhe duke mbajtur parasysh praktikat profesionale;
- Përbushja e detyrave kërkon aftësi analitike dhe planifikim të pavarur;
- Nga zyrtarët e kësaj klase kërkohet dhe pritët të identifikojnë mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe teknikave;
- Nga zyrtarët e kësaj klase kërkohet dhe pritët të diskutojnë rezultatet e punës me eprorin e tyre dhe t'i referohen atij vetëm në rastet e problematikave/çështjeve jo të zakonshme;
- Eprori kontrollon punën e zyrtarit të kësaj klase, vetëm sa i takon rezultatit dhe zakonisht nuk ndërhyjnë lidhur me përmbajtjen e saj;
- Zyrtari i kësaj klase mbikëqyr punën e Institucioneve Edukativo Arsimore dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe performancën e tyre për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi ligjore;
- Sipas nevojës, rishikon dhe kontrollon punën e zyrtarëve të tjerë profesional të nivelit më të ultë, duke sugjeruar dhe udhëzuar kryerjen e punëve profesionale.

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Nr. i kërkuar
RPC0000942	RN00007086	Inspektor i Arsimit	Profesional 1	111-7	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektoriati i Arsimit të Kosovës	SIA në Pejë / SIA - Pejë	3

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim



- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin për diplomat e marra jashtë vendit;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Certifikatë/vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;
- Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar e punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet parashikuara në nenin 8 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.6) të Ligjit Nr.06/L – 114 për Zyrarët Publik.

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Aftësitë e përgjithshme, aftësitë hulumtuese, analitike, vlerësuese, formulim të rekomandimeve, këshillave, komunikimit dhe planifikimit si dhe njohurive, aftësive dhe cilësive tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:



Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

